

VENDIM
Nr.71, datë 3.2.1997

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.433, DATË
3.9.1993 “PËR NDALIMIN E IMPORTIMIT TË GOMAVE TË PËRDORURA”**

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i dytë i pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.433, datë 3.9.1993, ndryshohet si vijon:

“Përfshihen nga ky vendim gomat e riveshura, ato që importohen me destinacion riveshjen e tyre nga subjektet e licencuara për këtë veprimtari, si dhe gomat e montuara në mjetet që importohen”.

2. Shtohet pika 1/a me këtë përmbajtje:

“Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit të përcaktojnë sasinë vjetore të gomave që importohen për riveshje dhe sasinë për çdo subjekt të specifikuar për çdo tremujor, në përputhje me aftësinë riveshëse të çdo subjekti të licencuar nga këto dy ministri”.

3. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Industrisë, Transportit e Tregtisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Ambientit të përcaktojnë rregullat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi